

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6761
E premte, 18 nëntor 2022
çmimi 0.40 €

2 547 ushtarakë
të FSK-së janë trajnuar
gjatë këtij viti | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DY LIDERËT E OPOZITËS, MEMLI KRASNIQI DHE LUMIR ABDIXHIKU, VAZHDOJNË
VIZITËN NË SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) | FAQE 5

DY LIDERËT E OPOZITËS NË UASHINGTON: EDHE SOT KEMI NEVOJË PËR MBËSHTETJEN E SHBA-së



Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, po vazhdojnë vizitën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Në takimet që kanë pasur me zyrtarë të lartë amerikanë, ata

kanë theksuar se tregimi i suksesit të Kosovës që nga çlirimi, pavarësia dhe shtetndërtimi është bërë falë bashkëpunimit të ngushtë me ShBA-në. Krasniqi dhe Abdixhiku kanë thënë se Kosova ka ende nevojë për mbështetjen e ShBA-së

AKTUALE



PROPOZIMI I ÇEKISË PËR
LIBERALIZIMIN E VIZAVE
NUK KALON | F. 3

SVEÇLA: KOSOVA E KONSIDERON
MIGRIMIN E PARREGULLT,
NJË NGA SFIDAT KRYESORE
NË TË ARDHMEN | F. 7

"NË FESTAT DHE GËZIMET TONA,
ARMËT NUK KANË VEND" | F. 6

EKONOMI



BIZNESET E KOSOVËS FILLOJNË
TË INVESTOJNË NË BURIMET E
RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË | F. 8

DHOMA E TREGTISË KËRKON
KRIJIMIN E LIGJIT
MBI ODAT/DHOMAT | F. 8

SPORT



FLAMURTARI DHE PRIZRENI
SHKAKTOJNË BEFASI NË KUPË,
ELIMINOJNË DRENICËN DHE ISTOGUN | F. 10



ILIR
IBRAHIMI:
KURTIT SHUMË
MË TEPËR DO
T'I SHKONTE
POZITA E
PRESIDENTIT | FAQE 3



KDI-ja: PROJEKTLIGJI PËR
PAGA, TENDENCË PËR NIVELIZIM
APO NDËRHYRJE?! | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zgjedhjet në ShBA: Republikanët me fitore të ngushtë në Dhomën e Përfaqësuesve

UASHINGTON, 17 NËNTOR - Republikanët kanë siguruar 218 vendet e nevojshme për një shumicë në dhomën e ulët të Kongresit një javë pas zgjedhjeve të mesmandatit, sipas projekteve të medimeve amerikane. Përderisa diferenca e partisë në Dhomën e Përfaqësuesve është e pakët, mjafton që ta pengojë agjendën e presidentit Joe Biden për dy vjetët e ardhshëm. Kevin McCarthy, udhëheqësi i republikanëve në Dhomën e Përfaqësuesve, festoi rezultatin. Por demokratët do ta ruajnë kontrollin e dhomës së sipërme, Senatit.

Kongresi i ri do të mbledhet në janar

Republikanët - të cilët kishin shpresuar të rifitonin kontrollin e

të dy dhomave - performuan nën pritshmëritë në zgjedhjet e mesmandatit të javës së kaluar. Por ata fituan vendin që u nevojitej për shumicën e tyre në Dhomën e Përfaqësuesve të mërkurën, kur distrikti i 27 i Kalifornisë shkoi te Mike Garcia.

Partia Republikane tani parashikohet të fitojë 218-223 vende në Dhomën e Përfaqësuesve prej 435 vendesh, sipas CBS. Por me votat në disa gara të ngushta ku ende po numërohen votat, shumica e tyre mund të mos jenë të qarta për ditë apo edhe javë.

McCarthy, i cili u zgjodh nga republikanët të martën si kandidati i tyre për ta zëvendësuar demokraten Nancy Pelosi si kryetaren e ardhshme të Dhomës së Përfaqësuesve, tha se dhoma ishte "ndryshuar zyrtarisht". "Amerikanët janë gati për një drejtim të ri dhe republikanët e



Dhomës së Përfaqësuesve janë gati të japin rezultat", ka theksuar kongresmeni nga Kalifornia.

Për t'u zgjedhur kryetar, udhëheqësi i pakicës republikane

në Dhomën e Përfaqësuesve duhet ta fitojë mbështetjen e shumicës nga 435 anëtarët e Dhomës së plotë. Gruaja e parë që mbajti këtë post, Pelosi, 82, nuk tha

asgjë në deklaratën e saj për shtyp nëse planifikonte të qëndronte si udhëheqëse e pakicës, mes spekulimeve në Uashington për të ardhmen e saj.

Kremlini thotë se nuk mund të imagjinojë negociatë publike me Kievin

MOSKË, 17 NËNTOR - Kremlini akuzoi të enjten Kievin për ndryshimin e objektivave në lidhje me bisedimet e mundshme të paqes.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, ka thënë se Kremlini nuk mund ta imagjinonte përfshirjen në negociatë publike dhe i bëri thirrje Uashingtonit që ta shtyjë Kievin drejt diplomacisë.

Në një telefonatë informuese me gazetarët, Peskov tha se Shtetet e Bashkuara ishin të afta t'i merrnin parasysh shqetësimet e Rusisë dhe mund ta inkurajonin Kievin që të kthehej në tryezën e bisedimeve nëse do të dëshironte.

Peskov tha, gjithashtu, se Ukraina kishte ndryshuar pozicionin e saj nëse donte të negocionte me Moskën disa herë gjatë rrjedhës së konfliktit



nëntëmujor dhe nuk mund të mbështetej tek ajo. "Fillimisht

ata negociojnë, pastaj refuzojnë të negociojnë, pastaj miratojnë

një ligj që ndalon çdo lloj negociate, pastaj thonë se duan

negociatë, por ato të jenë publike", u tha Peskov gazetarëve. "Prandaj është e vështirë të imagjinohen negociatat publike... Një gjë është e sigurt: ukrainasit nuk duan asnjë negociatë", shtoi ai.

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, më 15 nëntor u tha udhëheqësve botërorë se koha për t'i dhënë fund luftës së Rusisë në Ukrainë është "tani". "Jam i bindur se tani është koha kur lufta shkatërruese ruse duhet dhe mund të ndalet", tha ai, duke iu drejtuar samitit të G20-s, apo grupit të vendeve më të industrializuara, që po mbahet në Bali të Indonezisë. Ndajja e luftimeve "do të shpëtonte mijëra jetë", tha Zelensky përmes videolidhjes. Rusia ka nisur pushtimin në shkallë të gjerë të Ukrainës në fund të shkurtit.

BE-ja kërkon që Bullgaria, Kroacia dhe Rumania t'i bashkohen zonës Shengen

BRUKSEL, 17 NËNTOR - Komisioni Evropian bëri thirrje që Bullgaria, Kroacia dhe Rumania të pranohen në zonën Shengen për ta lejuar udhëtimin midis këtyre vendeve dhe pjesës më të madhe të Evropës, pa kontrolle kufitare. Ekzekutivi i BE-së i kërkoi Këshillit Evropian t'i marrë vendimet e nevojshme për të pranuar tri vendet e Evropës Lindore në zonën për lëvizjen e lirë, Shengen.

Bullgaria dhe Rumania përfunduan procesin e vlerësimit në vitin 2011. Këshilli konfirmoi në dhjetor 2021 se Kroacia, e cila u bë anëtare e BE-së në 2013, kishte përmbushur kushtet për t'u bashkuar me zonën Shengen. Në fund të gushtit, kancelari gjerman Oalf Scholz tha se këto tri shtete i plotësojnë të gjitha kriteret që të bëhen anëtare me të drejta të plota në këtë zonë. Aktualisht pesë anëtare të BE-së -

Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Irlanda dhe Rumania - nuk janë anëtare të Shengenit dhe, për këtë arsye, nuk mund të lëshojnë viza për gjithë zonën. Kërkesat për vizë janë të ngjashme, por viza është e vlefshme vetëm për vendin që e lëshon atë. Në anën tjetër, Islanda, Norvegjia dhe Zvicra nuk janë anëtare të BE-së, por janë anëtare të zonës Shengen. Prandaj, ato mund të lëshojnë viza për gjithë zonën.



Propozimi i Çekisë për liberalizimin e vizave nuk kalon

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Pasditen e 16 nëntorit skadoi afati për vendet e BE-së që me të ashtuquajturën procedurë të heshtur t'i paraqesin vërejtjet e tyre në lidhje me propozimin e Çekisë për liberalizimin e vizave për Kosovën.

Nga burimet diplomatike në Bruksel mësohet se "së paku dy shtete" e ndërprejnë këtë procedurë dhe penguan që propozimi të marrë dritën e gjelbër. Sipas burimeve, Spanja ishte ajo që paraqiti vërejtje, ndërsa disa shtete të tjera kërkuar më shumë sqarime.

Propozimi i Çekisë, vend që aktualisht udhëheq Presidencën e BE-së, ishte që hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave për Kosovën të lidhej me funksionalizimin e sistemit të udhëtimit ETIAS, siç kërkoi Franca, njëherësh të caktohej edhe data e fuqizimit të vendimit "jo më vonë se 1 dhjetori i vitit 2023".

Burimet diplomatike, megjithatë, thonë se situata e krijuar nuk do të thotë se propozimi çek nuk do të kalojë as në të ardhmen.

Tani pritet që Presidenca çeke, në takime dypalëshe me vendet që paraqitën vërejtje, t'i sqarojë disa çështje teknike. Sipas burimeve, po ashtu synohet që propozimi të kalojë në nivel më të lartë, atë të ambasadorëve, para fundit të këtij viti.

Spanja, e cila do ta marrë udhëheqjen e Presidencës së BE-së në gjysmën e dytë të vitit 2023, sipas burimeve, do të



preferonte që hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave për Kosovën të shtyhet për një muaj, përkatësisht më 1 janar të vitit 2024. Arsyet për këtë nuk janë të qarta.

Diplomatët në BE, megjithatë, besojnë se Presidenca çeke gjatë dy javëve të ardhshme do ta arrijë pajtimin e vendeve anëtare për miratimin e propozimit të saj.

Mësohet se edhe Sllovakia - që sikurse Spanja nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës - kërkoi "disa sqarime" rreth propozimit çek.

Lidhja me sistemin ETIAS

Në një takim të grupit punues për viza të Këshillit të BE-së, të mbajtur më 13 tetor, zyrtarët francezë propozuan që liberalizimi i vizave për Kosovën të lidhet me funksionalizimin e të ashtuquajturit sistem ETIAS.

Ky sistem digjital synon ta bëjë evidentimin e vizitorëve që hyjnë prej jashtë BE-së në zonën e lëvizjes së lirë, Schengen.

ETIAS është dashur të nisë së funksionuari në vitin 2022, por data është shtyrë disa herë dhe

tani si afat përmendet nëntori i vitit 2023.

Kërkesa e Francës erdhi me gjithë faktin se Komisioni Evropian, qysh në vitin 2018, ka konfirmuar disa herë se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave.

Kosova është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor, qytetarët e të cilit nuk mund të lëvizin lirshëm në zonën Schengen, të përbërë prej 26 shtetesh evropiane.

Vendet e tjera të rajonit ka më shumë se një dekadë që gëzojnë udhëtimin pa viza.

Ilir Ibrahimimi: Kurtit shumë më tepër do t'i shkonte pozita e presidentit



PRISHTINË, 17 NËNTOR - Analisti Ilir Ibrahimimi ka thënë se Albin Kurtit shumë më tepër do t'i shkonte pozita e presidentit. "Nëse analizohen me kujdes dhe me objektivitet zhvillimet e dy vjetëve të fundit, mund të arrijmë në një konkludim se zotit Kurti shumë më tepër do t'i shkonte pozita e presidentit sesa ajo e kryeministrit. Pozita e presidentit, si një pozitë ceremoniale, pa ndonjë përgjegjësi të theksuar vendimmarrëse, do t'i ofronte

z. Kurti platformën të cilën duket se ai e ka më së shumti për qejf: pjesëmarrjen në seminare, vizita jashtë shtetit, fjalime në universitete prestigjioze, simpoziume shkencore e të tjera. Në të njëjtën kohë edhe adhuruesit e tij do të kënaqeshin sepse do t'u bëhej idoli president", ka shkruar Ibrahimimi në "Facebook".

Në anën tjetër, sipas tij, do të hapej mundësia për formimin e një qeverie e cila do ta kishte

përvojën, vullnetin dhe kuadrot e duhura për t'u përballur me krizat që i kemi përpara. "Ndoshta në shikim të parë kjo mund të duket si një shaka, por never say never. Kemi mjaft presedane të së kaluarës që e bën një lëvizje të tillë të mundshme. Përveç kësaj, vizita e liderëve opozitarë në ShBA, kriza me veriun, presioni për arritjen e një marrëveshjeje me Serbinë janë zhvillime që mund të sjellin ndryshime të tilla", ka thënë Ibrahimimi.

Betohen deputetët e rinj të Listës Serbe dhe largohen nga salla e Kuvendit

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Lista Serbe ka bërë me dije të enjten se nëntë deputetët e rinj të kësaj partie u betuan në Kuvendin e Kosovës për t'i "verifikuar teknikisht mandatet e tyre" dhe "për t'i mbajtur ato në duar të sigurt". "Theksojmë se ky vendim strategjik dhe politik në asnjë mënyrë nuk do ta ndalë

procesin e largimit nga institucionet e Kosovës në veri të Kosovës dhe Metohisë, me të cilat janë shuar të gjitha institucionet e Kosovës", thuhet në komunikatën e Listës Serbe. Deputetët që u betuan po zëvendësojnë mandatet e dhjetë deputetëve të mëhershëm, të gjithë nga Lista Serbe.

Në Kuvendin e Kosovës u betuan: Millan Kostiq, Zoran Maksimoviq, Svetislav Gjokiq, Ksenija Bozhoviq, Radosh Mihajlloviq, Bilana Makshiq, Milan Joksimoviq, Nenad Radenkoviq, Olivera Zdravkoviq nga Lista Serbe, si dhe Cvetko Velkoviq nga partia Iniciativa qytetare për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë.





DY LIDERËT E OPOZITËS, MEMLI KRASNIQI DHE LUMIR ABDIXHIKU, VAZHDOJNË VIZITËN NË SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA)

Dy liderët e opozitës në Uashington: Edhe sot kemi nevojë për mbështetjen e ShBA-së

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, po vazhdojnë vizitën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Në takimet që kanë pasur me zyrtarë të lartë amerikanë, ata kanë theksuar se tregimi i suksesit të Kosovës që nga çlirimi, pavarësia dhe shtetndërtimi është bërë falë bashkëpunimit të ngushtë me ShBA-në. Krasniqi dhe Abdixhiku kanë thënë se Kosova ka ende nevojë për mbështetjen e ShBA-së

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

UASHINGTON, 17 NËNTOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, në ditën e dytë të vizitës së tij zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është pritur në Departamentin Amerikan të Shtetit nga zëvendësndihmësi i Sekretarit të Shtetit, Gabriel Escobar, njëherësh i dërguar i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor.

Kryetari i PDK-së e ka falënderuar Escobarin për të gjitha etapat e mbështetjes së palëkundur amerikane për Kosovën. Në këtë takim Krasniqi ka shprehur qëndrimin e PDK-së se rreshtimi dhe bashkëpunimi i Kosovës me ShBA-në është pa alternativë. Ai ka theksuar se ShBA-ja i ka dhënë dhe i jep Kosovës mbështetje të vazhdueshme në procesin e integritetit dhe fuqizimit në arenën ndërkombëtare, përfshirë synimin

e Kosovës për anëtarësim në NATO, BE dhe OKB. "Z. Escobar e sigurova se qëndrimi i popullit të Kosovës, pa dyshim edhe i PDK-së si lidere e opozitës, për ruajtjen dhe fuqizimin e raporteve bilaterale dhe strategjike ndërmjet Kosovës dhe ShBA-së, është i padiskutueshëm dhe i pandryshueshëm. Kur Shtëpia e Bardhë është adresa dhe kur aleanca me ShBA-në është rruga, afirmimi dhe suksesi kombëtar e shtetëror i Kosovës është destinacion i pashmangshëm", ka deklaruar Krasniqi.

Kreu i PDK-së, Memli Krasniqi, e ka siguruar Escobarin se PDK-ja do ta ofrojë gjithë mbështetjen dhe ndihmën e saj për çdo çështje që prek interesin shtetëror të Kosovës. "Gjatë takimit diskutuam edhe për situatën dhe sfidat aktuale për sigurinë e Kosovës dhe domosdoshmërinë e shtimit të përpjekjeve në dialog me Serbinë, për arritjen e një marrëveshjeje

gjithëpërfshirëse, me njohjen reciproke në qendër", ka thënë Krasniqi. Ai ka theksuar se tregimi i suksesit të Kosovës që nga çlirimi, pavarësia dhe shtetndërtimi është bërë falë bashkëpunimit të ngushtë me ShBA-në.

Krasniqi në kuadër të kësaj vizite e ka takuar edhe profesorin Daniel Serwer, një nga njohësit më të mirë të zhvillimeve politike në Ballkanin Perëndimor. "Si një personalitet që ndjek me vëmendje zhvillimet në Kosovë dhe i njëj mirë çështjet e sigurisë, bashkë folëm për situatën e krijuar në pjesën veriore të vendit dhe nevojën për veprime të përgjegjshme politike. Ishte pajtim i përbashkët, që në mesin e agresionit të pprovokuar rus kundër Ukrainës, Kosova duhet të vazhdojë t'i forcojë raportet me ShBA-në dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë", ka deklaruar Krasniqi pas takimit.

Takimet në Uashington, lideri i PDK-së i ka vazhduar në Institutin

Nacional Demokratik (NDI) dhe Institutin Republikan Ndërkombëtar (IRI). Krasniqi ka theksuar se NDI dhe IRI janë prej organizatave më të rëndësishme për avancimin e lirisë dhe demokracisë në mbarë botën përmes asistencës konkrete që u japin partive politike. "Si institute të cilat merren shumë me rritjen e rolit qytetar në procesin politik, duke përfshirë gratë dhe të rinjtë, bashkë diskutuam për nismat e fundit të PDK-së që kanë të bëjnë pikërisht me këto dy kategori. Vizioni dhe qëllimi ynë për barazi të plotë gjinore, 50/50, në të gjitha strukturat e partisë dhe fuqizimi i platformës së rinisë, si një gjenerator i reformave politike, u vlerësua lart nga të gjithë", ka deklaruar Krasniqi, duke shtuar se drejtuesit e këtyre dy instituteve i ka falënderuar për bashkëpunimin dhe kontributin e çmuar që po vazhdojnë të japin për demokratizimin e shoqërisë sonë në Kosovë.

Edhe lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, gjatë vizitës së tij zyrtare në ShBA, është pritur në Departamentin Amerikan të Mbrojtjes. Në Pentagon Abdixhiku ka zhvilluar takim me drejtorin kryesor të Departamentit të Mbrojtjes për Evropën dhe Politikën e NATO-s, Andrew L. Wintemitz. Në këtë takim,

Abdixhiku shprehu mirënjohjen e thellë ndaj Departamentit të Mbrojtjes për kontributin e dhënë për Kosovën në të gjitha etapat historike.

Në veçanti, Abdixhiku vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme që Departamenti Amerikan i Mbrojtjes jep ndaj Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe kapaciteteve ushtarake të Republikës së Kosovës. Në Pentagon, Abdixhiku kërkoi mbështetje të mëtutjeshme të ShBA-së për realizimin e aspiratës historike të popullit të Kosovës për anëtarësim sa më të shpejtë në NATO.

Në këtë takim u shtruan edhe kërkesat e pikëpamjet e LDK-së për "Kartën për Partneritet Strategjik mes ShBA-së dhe Kosovës sikurse shndërrimi i Kampit Bondsteel në bazë të përhershme amerikane në Kosovë".

Abdixhiku takimet i ka vazhduar në Kongresin Amerikan, ku është pritur nga kongresmeni demokrat Dutch Ruppersberger. "E urova për rizgjedhjen në mandatin e ri. Përvoja e tij disadekadëshe në politikën amerikane është vlerë e jashtëzakonshme. Roli i tij në administratën e tanishme dhe simpatia e përhershme për Republikën e Kosovës është mundësi e madhe për ne. Shndërrimi i bazës amerikane të

Kuvendi miraton projektbuxhetin e shtetit për vitin 2023

Kuvendi i Kosovës ka miratuar në lexim të parë Projektligjin për Buxhetin e vitit 2023. Në favor të këtij projektligji

kanë votuar 64 deputetë, kurse një ka qenë kundër. Buxheti i shtetit për vitin 2023 do të jetë 3 miliardë e 212

milionë euro. Projektligji për buxhetin e vitit 2023 është kritikuar nga opozita, e cila nuk ka marrë

pjesë në votim. Sipas opozitës, buxheti i shtetit për vitin 2023 është jozhvillimor.



2 547 ushtarakë të FSK-së janë trajnuar gjatë këtij viti



Prishtinë, 17 nëntor - "2 547 është numri i ushtarakëve të FSK-së të trajnuar vetëm gjatë këtij viti", kështu ka bërë me dije të enjten ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj. Ai ka thënë se avancimi profesional i pjesëtarëve të

Ushtresë së Republikës së Kosovës përbën njërin ndër synimet më të rëndësishme të Ministrisë së Mbrojtjes. "Përgjatë këtyre 19 muajve është investuar maksimalisht në financimin e trajnimeve të ushtarakëve tanë

përkrah ushtrive të shteteve më të fuqishme aleate. Përmes bashkëpunimit me partnerët tanë strategjikë në fushën e trajnimeve, po ngrehim në vazhdimësi kapacitetet profesionale dhe operacionale në funksion të

misionit tonë kushtetues, gjithmonë në shërbim të paqes, stabilitetit dhe sigurisë së shtetit të Republikës së Kosovës, e përtej kësaj ky bashkëpunim në avancimin profesional të ushtarakëve kontribuon në

përmbushjen e vizionit për anëtarësim në NATO", ka thënë ministri Mehaj, duke shtuar se investimi i vazhdueshëm në FSK është garanci për ushtrinë që i shërben ruajtjes së paqes në vend, rajon dhe më gjerë.

Bondsteelit në bazë ushtarake të përhershme ishte temë e përbashkët e diskutimit tonë. Kongresmeni Ruppertsberg ka përkushtim të madh për rrugëtimin e Kosovës drejt familjes euroatlantike. Kontributi i tij në këtë drejtim do të jetë jetik për të ardhmen e sigurisë së popullit tonë. Kongresmenin Dutch Rulpersberger e ftova edhe për vizitë në Kosovë", ka thënë Abdixhiku.

Ai ka takuar edhe kongresmenin republikan Robert Aderholt, të cilit i ka uruar rizgjedhjen nga gara e javës së kaluar. "Kongresmeni Aderholt është një mik i madh i Kosovës. Në rolin e bashkudhëheqësit të grupit për çështjet shqiptare, ai e ka shtyrë në vazhdimësi pozicionin e Kosovës në Kongresin Amerikan dhe politikën e jashtme amerikane. Për këtë e falënderova përzemërsisht. Të njëjtin e ftova për vizitë në Kosovë. Populli i Kosovës mbetet falënderues për kontributin e kongresistëve në momente të ndryshme historike. Për këtë mbështetje kemi nevojë edhe sot", është shprehur lideri i LDK-së. Abdixhiku ka vazhduar takimet në Senatin e Shteteve të Bashkuara, ku u prit nga senatori Christopher Murphy dhe ekipi i tij politik. "Biseduam për zhvillimet e fundit politike në Kosovë dhe rajon. Edhe

në Senat shtrova kërkesën tonë për ngritjen e bashkëpunimit bilateral në mes të Kosovës dhe ShBA-së nëpërmjet 'Kartës për Partneritet Strategjik'. Si anëtar i Komisionit për Punë të Jashtme, senatori Murphy ka qenë dhe mbetet gjithherë aktiv në rajonin tonë. Në këtë drejtim kërkesat tona për mbështetje ndaj popullit të Kosovës, institucioneve të Republikës e aspiratave tona për anëtarësim në aleancën ushtarake të NATO-s ishin krejt të natyrshme. Po ashtu, në takim u theksua nevoja e bashkëpunimit të ngushtë në fushën e politikës së jashtme, energjetikës dhe zhvillimit ekonomik", ka thënë Abdixhiku. Para këtyre takimeve Abdixhiku kishte zhvilluar takim edhe me të dërguarin e Posaçëm të ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar. Abdixhiku në emër të LDK-së dhe qytetarëve të Kosovës, Escobarit i prezantoi pikëpamjet e LDK-së mbi gjendjen e fundit të sigurisë në Kosovë, si dhe nevojën e bashkëpunimit të ngushtë të institucioneve të Kosovës me ShBA-në dhe me partnerët e tjerë. "Për shtetin tonë të ri, aleanca me ShBA-në është jetike. Kështu ka qenë tash e më shumë se tri dekada. Aleanca dhe bashkëpunimi i ngushtë me ShBA-në dhe me partnerët evropianë, Kosovës ia kanë sjellë lirinë dhe pavarësinë. Populli i



Kosovës është përjetë mirënjohës për të gjithë angazhimin e partnerëve tanë. Edhe një herë u bëj thirrje institucioneve të vendit që të bashkëpunojnë ngushtë me ShBA-në dhe partnerët e tjerë në funksion të shtrirjes së sundimit të ligjit në të gjithë territorin e Kosovës, të sigurisë dhe të prosperitetit për të gjithë", ka deklaruar Abdixhiku, duke shtuar se LDK-ja e shqetësuar me degradimin e raporteve Kosovë - ShBA. Për vizitë në ShBA nuk ka mundur të udhëtojë ministrat e Kurtit, ministrja e Drejtësisë, Albulena

Haxhiu, ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, si dhe kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi. Ky refuzim i vizitës vjen pas kërkesave të vazhdueshme të autoriteteve ndërkombëtare për shtyrje të vendimit për targa, vendim ky që ka prodhuar zhvillimet e fundit. Kur është pyetur nga mediet në lidhje me këtë, ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka theksuar se nuk e sheh të vështirë që një ministër të marrë vizë amerikane, por tani për tani, për shkak të krizës pas ngjarjeve në

veri, nuk është koha e duhur që ministrat të udhëtojnë për në ShBA për takime zyrtare. "Ne aktualisht jemi në një krizë, dhe është pikëpamja jonë që ne jemi tejet të përqendruar në këtë krizë. Besojmë që edhe kjo qeveri është e përqendruar në këtë krizë, dhe mendojmë se nuk është koha më e duhura që ministrat të jenë duke udhëtuar për në ShBA për takime zyrtare duke e pasur parasysh krizën të cilën duhet trajtuar këtu. Dhe këtë po ua komunikojmë zyrtarëve të ndryshëm në qeveri", ka thënë Hovenier.



Kompletohet Endoskopia me pajisje të reja mjekësore

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Kabineti i Endoskopisë në Klinikën e Gastroenterologjisë në QKUK është kompletuar pas ardhjes së pajisjeve të reja mjekësore dhe ridizajnimit të hapësirave. Menaxhmenti i ShSKUK-së e ka pajisur këtë klinikë me katër gastroskopë dhe katër kolonoskopë të rinj, të markës Olympus dhe Karl Storz, duke përmbytur plotësisht nevojat për trajtim

endoskopik të pacientëve. Pas ndërhyrjeve të fundit, Kabineti i Endoskopisë është bërë me tri salla, listë të pritjes nuk ka dhe pacientët marrin shërbimet e nevojshme shumë shpejt. Në një ceremoni zyrtare, u.d. ministrja e Shëndetësisë, Dafina Gexha-Bunjaku, zëvendësministri i Shëndetësisë, Arsim Berisha, u.d. drejtoresha e ShSKUK-së, Pranvera Zejnullahu-Raçi, dhe kryesuesja e Bordit

Drejtuës të ShSKUK-së, Aida Rexhepi, bashkë me anëtarët e tjerë të bordit, kanë përfunduar pajisjet e reja dhe kanë përgëzuar menaxhmentin e klinikës për punën e jashtëzakonshme, ndërkohë kanë premtuar mbështetje të vazhdueshme dhe janë zotuar për investime të tjera në të gjitha klinikat, që kanë synim rritjen e cilësisë së shërbimeve mjekësore dhe krijimin e kushteve të punës për punëtorët shëndetësorë.

'Në festat dhe gëzimet tona, armët nuk kanë vend'

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Në kuadër të fushatës "Çdo plumb e ka një shënjestër - festo me zemër, jo me armë", Ministria e Punëve të Brendshme, mbështetur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe në bashkëpunim me komunën e Hanit të Elezit, ka mbajtur takim me banorët e fshatit Gorancë, në Shkollën Fillore "Veli Ballazhi", për ta rritur ndërgjegjësimin e banorëve të kësaj pjesë që jetojnë në kufi me Republikën e Maqedonisë së Veriut sa i përket përdorimit të armëve.

Në këtë aktivitet morën pjesë zëvendësministri i Punëve të Brendshme dhe kryesuesi i Komisionit për Armët e Vogla dhe të Lehta (AVL), Blerim Gashani, kryetari i komunës së Hanit të Elezit, Mehmet Ballazhi dhe zëvendëspërfaqësuesi i përhershëm i UNDP-së në Kosovë, Niels Knudsen. Me këtë rast, zëvendësministri Gashani ka theksuar se trafikimi dhe

zotërimi i paligjshëm i armëve, krimet me armë edhe pse paraqiten në rënie çdo vit, ende shfaqen si kërcënim për jetën njerëzore dhe rendin e sigurinë publike në Kosovë.

Gashani vuri në dukje se edhe qëllimi i këtij aktiviteti në fshatin Gorancë të Hanit të Elezit, fshat në kufi me Maqedoninë e Veriut, është bërë me qëllim që të njoftohen banorët e këtyre zonave se ndërveprimi dhe bashkëpunimi mes grupeve kriminale me ato terroriste nuk njih kufij ndarës, prandaj edhe qasja e kësaj fushate dhe projektit të përbashkët në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut duhet të jetë qasje ndërinstucionale dhe ndërkufitare. Ai ka theksuar se Policia e Kosovës në baza vjetore konfiskon rreth 1 500 armë ilegale të llojeve të ndryshme.

Zëvendëspërfaqësuesi i përhershëm i UNDP-së në Kosovë, Niels Knudsen, ka theksuar se çdo ditë rikujtojnë se



armët, krimi dhe dhuna përbëjnë kërcënim edhe në shoqëritë më paqësore.

Fushata "Çdo plumb e ka një shënjestër - festo me zemër jo me armë", ka filluar më 6 nëntor me

një manifestim hapës që është mbajtur njëkohësisht në Prishtinë dhe Shkup.

Mehaj merr pjesë në Forumin Ndërkombëtar të Sigurisë në Halifax të Kanadasë



PRISHTINË, 17 NËNTOR - Me ftesë zyrtare të homologes kanadeze, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, së bashku me zv/komandantin e FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, kanë udhëtuar për në Halifax të Kanadasë për të marrë pjesë në Forumin Ndërkombëtar të Sigurisë.

Gjatë punimeve të forumit, në sesion të veçantë, ministri Mehaj para liderëve të shumtë, ministra e shefa të mbrojtjes të shumë vendeve të botës, do të

prezantojë temën "Sigurimi i sovranitetit të shteteve të vogla". Gjithashtu, në takim të veçantë do të pritet nga nikoqirja dhe homologia e tij, ministrja e Mbrojtjes Kombëtare të Kanadasë, Anita Anand, krahas takimeve të shumta në margjina të forumit me ministra e shefa të mbrojtjes së vendeve të ndryshme, nga të cilat veçojmë takimin me kryetarin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiralin Rob Bauer.

Krahas pjesëmarrjes efektive në

forum, ministri Mehaj me delegacionin e tij do të priten nga diaspora jonë në Kanada, ku do të marrin pjesë edhe në takimet dhe organizimet e tyre. Forumi Ndërkombëtar të Sigurisë në Halifax është i përkushtuar për forcimin e bashkëpunimit strategjik midis vendeve demokratike për përballjen me sfidat, kërcënimet dhe rreziqet e mjedisit të sigurisë globale, e sivjet fokusin do ta ketë në krizën e Ukrainës pas agresionit ushtarak të Rusisë.

Sulmohet një kameraman në Mitrovicë të Veriut

MITROVICË, 17 NËNTOR - Një kameraman dhe një qytetar tjetër janë sulmuar të enjten në Mitrovicë të Veriut. Sulmin e ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë", zëvendës drejtori i policisë për rajonin e Mitrovicës së

Veriut, Besim Hoti. Ai ka thënë se rasti po hetohet dhe deri më tani nuk ka ndonjë të arrestuar.

Më herët, mediumi "Insajderi.org" ka njoftuar se kameramani i quajtur Jetmir Muji është sulmuar të enjten.

Në lajmin që është publikuar në "Insajderi" thuhet: "Muji është sulmuar nga bandat serbe në veri derisa ishte duke xhiruar rastin e një kidnapimi të një të riu shqiptar në pjesën veriore të Kosovës".

Deri më tani Policia e Kosovës, as institucionet e tjera, nuk kanë dhënë detaje zyrtare në lidhje me ngjarjen. Ndërsa Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka reaguar ndaj sulmit duke e dënuar ashpër atë.



KDI-ja: Projektligji për Paga, tendencë për nivelizim apo ndërhyrje?!

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 17 nëntor - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar të enjten analizën "Projektligji për Paga, tendencë për nivelizim apo ndërhyrje". Duke iu referuar përpjekjeve të pasuksesshme të disa qeverive tash e disa vjet për t'i harmonizuar pagat e sektorit publik me një ligj të vetëm, analiza e KDI-së i trajton tre çështje: i) aspektin e ndërhyrjes së qeverisë në sistemin e drejtësisë përmes këtij projektligji; ii) përfshirjen e institucioneve të pavarura në kuadër të tij; si dhe iii) nevojën e përcaktimit të koeficientit të pagës.

Në raport me këto çështje, KDI ka elaboruar edhe standardet dhe praktikën ndërkombëtare në lidhje me caktimin e pagave për pushtetin gjyqësor. Projektligji për Paga vjen si një përpjekje e dytë e ekzekutivit për nivelizim të pagave në sektorin publik. Në vitin 2018 qeveria e atëhershme kishte paraqitur Ligjin për Paga i cili pas hyrjes në fuqi ishte dërguar për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Kjo gjykatë kishte konstatuar se ky ligj nuk ishte në përputhshmëri me 11 nene të Kushtetutës. Sidoqoftë, edhe versioni aktual i këtij projektligji i propozuar

nga qeveria në shtator 2022, ndonëse arsyeton nevojën për nivelizim të pagave në sektorin publik, nuk ka arritur t'i adresojë në tërësi konstatimet e Gjykatës Kushtetuese.

Gzime Hashani nga KDI-ja ka potencuar që legjislacioni në fuqi pamundëson uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë mandatit për të cilin ata janë emëruar, përveç nëse kjo arsyetohet nga një situatë e jashtëzakonshme e vështirësive financiare.

Meqenëse situata ekonomike dhe buxheti në Kosovë janë konsideruar nga ekzekutivi si më pozitivet vitet e fundit, ulja e pagave në sektorin gjyqësor, pavarësisht qëllimit të nivelizimit, nuk plotëson parakushtet ligjore. Për më tepër, bazuar në standardet dhe praktikën ndërkombëtare, edhe pagat në gjyqësor mund të ulen vetëm në kuadër të uljeve proporcionale të pagave në gjithë sektorët dhe një standard i tillë do të duhej të reflektuhej nga ky projektligj.

Në anën tjetër, Albesa Humolli nga KDI adresoi çështjen e përfshirjes së institucioneve të pavarura në projektligj, duke potencuar që Projektligji për Paga përmban paqartësi në lidhje me përfshirjen dhe pozicionin e institucioneve të pavarura.

Në këtë drejtim u theksua që



është i domosdoshëm respektimi i pavarësisë, rregullimi specifik, natyra e punës dhe klasifikimi i vendeve të punës brenda këtyre institucioneve.

Gjithashtu, edhe mospërfshirja në këtë projektligj e ndonjërit prej institucioneve të pavarura, si në rastin e AKI-së dhe BQK-së, duhet të arsyetohet për nevojën dhe rezultatin që do të sjellë ky përfshirje. Më tutje, Humolli përmend se mangësi e Projektligjit për Paga është

edhe mungesa e përcaktimit të vlerës monetare të koeficientit. Humolli e sheh si problematik përcaktimin e vlerës së koeficientit nëpërmjet Ligjit Vjetor të Buxhetit, meqenëse kjo e cenon parimin e parashikueshmërisë së këtij projektligji. Për më tepër, mosnjohja e vlerës së koeficientit krijon pasiguri juridike edhe te subjektet të cilat i nënshtrohen këtij projektligji si dhe pamundëson përcaktimin e kostos buxhetore

të vet ligjit.

Në fund u ritheksua që në kuadër të përpjekjeve të ekzekutivit për nivelizim të pagave në sektorin publik, duhet medoemos të merren parasysh vendimet e Gjykatës Kushtetuese, por edhe praktikën dhe standardet ndërkombëtare në mënyrë që të shmanget mundësia që ky projektligj të jetë sërish objekt i shqyrtimit të Gjykatës Kushtetuese dhe të shfuqizohet nga po e njëjta.

Sveçla: Kosova e konsideron migrimin e parregullt, një nga sfidat kryesore në të ardhmen

"Epoka e re"

Prishtinë, 17 nëntor - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka marrë pjesë në Konferencën Ministrore "Menaxhimi i qëndrueshëm i migrimit në Ballkanin Perëndimor" në Shkup. Me këtë rast, ministri Sveçla shprehu përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për adresimin e sfidave nga flukset e migracionit si rrjedhojë e dinamikave të reja të sigurisë dhe më gjerë, duke theksuar rëndësinë e hartimit të politikave të qëndrueshme të migracionit, të ndërtuara mbi një konsensus politik me qëllim të reagimit dhe parandalimit të formave të reja të migrimit. Ministri Sveçla, gjithashtu, ka theksuar se Kosova e konsideron migrimin e parregullt si një nga sfidat kryesore në të ardhmen dhe si rrjedhojë është një nga prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila ka si synim menaxhimin e migracionit të rregullt,

garantimin e migrimit të sigurt dhe mirë të organizuar si dhe fuqizimin e masave për të luftuar dhe parandaluar migrimin e parregullt.

Gjatë fjalimit të tij, ministri Sveçla ka paraqitur rezultatet e arritura në luftimin e kontrabandës me migrantë, ku vetëm këtë vit Policia e Kosovës ka iniciuar 32 raste të kontrabandës me migrantë, ka arrestuar 60 persona dhe ka identifikuar 332 viktima të kontrabandimit të emigrantëve. Gjatë të njëjtës periudhë Policia e Kosovës ka shkatërruar katër grupe kriminale dhe ka arrestuar 28 persona për kontrabandim me migrantë.

Ministri Sveçla ka theksuar nevojën për t'u përgjigjur situatave të reja të krijuara si rezultat i luftës së paprovokuar të agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, e cila ka ndikuar edhe në rritjen e flukseve të migrimit, kryesisht gra dhe fëmijë e ku deri më tani rreth 5 milionë refugjatë janë regjistruar në BE dhe më gjerë dhe, shprehur edhe një herë, gatishmërinë e



qeverisë që të strehojmë deri 5 000 refugjatë si dhe kontributin që si Kosovë kemi dhënë në mbrojtje të gazetarëve ukrainas, ku tashmë 11 prej tyre jetojnë dhe punojnë në Kosovë.

Në fund të fjalimit të tij, ministri Sveçla ka folur edhe një herë për angazhimin e qeverisë për të punuar së bashku për ta forcuar bashkëpunimin midis vendeve të Ballkanit

Perëndimor, BE-së dhe më gjerë, në mënyrë që t'u përgjigjemi të gjitha sfidave, si dhe ta garantojmë sigurinë dhe mbrojtjen e vlerave evropiane dhe të demokracisë.

Bizneset e Kosovës fillojnë të investojnë në burimet e ripërtëritshme të energjisë

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Dielli është burimi kryesor i energjisë që gjendet në planetin tokë, ndërsa vlerësohet se Kosova ka 240 ditë me diell në vit. Për ta shfrytëzuar këtë potencial të jashtëzakonshëm dhe për të kaluar në burime të pastra të energjisë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Kosovë, me ndihmën e BE-së, tashmë kanë filluar të investojnë në burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe t'i vjelin dobitë e tyre.

'Forma SHPK' është ndërmarrje e mesme e themeluar në vitin 2013 në fshatin Bresalc të komunës së Gjilanit. Ata prodhojnë produkte plastike të përdorura kryesisht në industrinë e trenave dhe tramvajeve si dhe i eksportojnë të gjitha në

Gjermani.

Për t'i ulur shpenzimet e tyre të energjisë dhe për të kontribuar në mbrojtjen e mjedisit, këtë vit kompania ka investuar në panele diellore me kredi të financuar nga Programi i BERZh-it për Mbështetjen e Konkurrueshmërisë së NVM-ve në Kosovë. Në kuadër të këtij programi, 'Forma SHPK' ka përfituar, po ashtu, ndihmë teknike falas nga një ekip konsulentësh ndërkombëtarë dhe një grant për kthimin e parave financuar nga BE-ja.

Besim Rexhi, menaxher në 'Forma SHPK', thotë se kompania ka shënuar rezultate të pabesueshme nga investimi.

"Ne kemi instaluar 112 kWp në panele diellore, të cilat po na ndihmojnë jashtëzakonisht për t'i ulur kostot tona të energjisë. Më parë paguanim rreth 1 200 euro në muaj për faturën e



energjisë elektrike, tani paguajmë rreth 200 euro. Kjo do të thotë që kostot tona të energjisë janë ulur rreth 80 për qind", ka treguar Rexhi.

Më tej, ai i ka inkurajuar bizneset në Kosovë që të fokusohen në burimet e pastra të energjisë. "E vetmja keqardhje që kam është fakti se nuk kam ditur më parë për benefitet e mëdha të energjisë së ripërtëritshme. Edhe pse panelet aktuale plotësojnë kërkesat e mia për energji, po të kisha mundësi do të instaloja edhe 100 panele diellore të tjera. Të kalosh në të gjelbër të bën të ndihesh mirë si sipërmarrës pasi, përveçse ul kostot e energjisë, në nivel personal të jep kënaqësi të dish se po i bën një nder planetit duke e mbrojtur", ka thënë Rexhi.

'Silca Group' është një tjetër ndërmarrje që po përfiton nga burimet e ripërtëritshme të energjisë. Me vendndodhje në fshatin Mirosale të komunës së Ferizajt, produkti kryesor i tyre është prodhimi dhe shitja e ujit të ambalazhuar në Kosovë dhe në rajon. Këtë vit, me ndihmën e BE-së, ata kanë instaluar 200 kWp në panele diellore.

Dardan Sadriu, drejtor i përgjithshëm i kësaj kompanie,

ka theksuar se investimi në energji të pastër është investim për të ardhme të shëndetshme dhe të qëndrueshme. "Duke pasur parasysh faktin se Kosova ka mjaft diell gjatë vitit, kemi vendosur të investojmë në energjinë diellore. Në këtë mënyrë na ndihmon t'i ulim shpenzimet tona në afat të gjatë dhe të kontribuojmë për një mjedis më të shëndetshëm. Falë BERZh-it dhe BE-së investimi ynë u mbështet me një grant prej 15-përqindësh, por edhe ndihmë teknike për t'i përmbushur direktivat e BE-së. Tashmë jemi më konkurrues në treg", ka deklaruar Sadriu.

Për momentin ai vlerëson se 15-20 për qind e energjisë së konsumuar nga kompania që ai drejton prodhohet nga energjia diellore. Bashkimi Evropian në Kosovë do të vazhdojë t'i mbështesë dhe financojë bizneset kosovare në fazën e tranzicionit nga burimet e paqëndrueshme dhe të dëmshme të energjisë në të pastra dhe të qëndrueshme, si energjia e prodhuar nga dielli, era, biomasa, uji etj.



Dhoma e Tregtisë kërkon krijimin e Ligjit mbi Odat/Dhomat

PRISHTINË, 17 NËNTOR - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë përmes një shkrese drejtuar kryeministrit Albin Kurti dhe ministres së Tregtisë dhe Industrisë, Rozeta Hajdari, ka kërkuar krijimin e një Ligji mbi Odat/Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë. Bazuar në faktin që aktualisht është në shqyrtim, Ligji mbi Odën Ekonomike të Kosovës, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë kërkon zgjerimin e grupit punues të krijuar për të themeluar një Ligj mbi Odat/Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë në mënyrë që përfundimisht të gjitha Dhomat/Odat të funksionojnë në kuadër të këtij ligji e jo siç janë duke funksionuar



DHOMA E TREGTISË DHE INDUSTRIËS KOSOVË
CHAMBER OF TRADE AND INDUSTRY KOSOVA

aktualisht si organizata joqeveritare. "Republika e Kosovës që nga paslufta ka përqafuar sistemin anglo-amerikan që mundëson krijimin e shumë dhomave/odave dhe jo sistemin tjetër ku në shtet

ekziston vetëm një odë/dhomë dhe anëtarësia është e obliguar. Siç dihet, sistemi ligjor në Kosovë e rregullon vetëm punën e Odës Ekonomike, ndërsa të gjitha odat/dhomat e tjera që funksionojnë në vend janë të krijuara si organizata

joqeveritare. Përmes këtij ndryshimi do të mundësohet rregullimi i mënyrës së funksionimit të të gjitha odave/dhomave që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Kosovës, përcaktohen kushtet dhe kriteret për të hapur një odë, gjithashtu mundëson që odat/dhomat të konkurrojnë në mënyrë të barabartë me njëra-tjetrën", është theksuar në njoftimin e Dhomes së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë.

Përveç kësaj, thuhet se Ligji për Odat/Dhomat është edhe në favor të bizneseve, sepse odat/dhomat do të aktivizohen vazhdimisht më shumë sesa aktualisht në mënyrë që

komuniteti i bizneseve që ato përfaqësojnë të jetë sa më i gjerë dhe të njëjtët të përfitojnë shërbime konkrete.

Gjithashtu, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë konsideron që anëtarësimi në oda/dhoma duhet të rregullohet në vullnetin e bizneseve, të cilat mund të zgjedhin se në cilën dhomë do të anëtarësohen.

Republika e Maqedonisë së Veriut është një nga shtetet që ka të rregulluar Ligjin e Odave me të cilin rregullon themelimin, organizimin, punën, financimin dhe shuarjen e odave/dhomave ekonomike që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e shtetit.

Pse Trump nuk duhet nënvlerësuar



Donald Trump dëshmon se nuk do të lejojë asgjë dhe askënd ta ndalë atë nga një kandidaturë e dytë. Sidomos jo nga votuesit. Një rrezik, jo vetëm për demokracinë në SHBA, thotë Michaela Küfner.

Përpara se Donald Trump të thoshte në Florida ato fjalë që i prisnin të gjithë, përmes faqes së tij të internetit, ai bëri thirrje për donacione për kandidaturën e tij në 2024.

Ekspertja kryesore e Trump në SHBA, gazetarja e New York Times, Maggie Habermann, e ka përshkruar vazhdimisht dhe në mënyrë mbresëlënëse Trump si një njeri që kur ka dyshime gjithmonë del në front. Pra, tani sërish po e bën, sepse është logjike që Trump të ngrihet tani, pasi votuesit amerikanë i refuzuan kandidatët e tij në zgjedhjet afatmesme, Midterms.

Dëshira e republikanëve për normalitet

Sidomos në të ashtuquajturat shtetet swing, si Michigan, Arizona dhe Nevada, që nuk i përkasin një kampi të caktuar e votojnë herë republikanët, e herë demokratët, fansat e Trump nuk donin të votonin për askënd që kapej pas gënjeshtërs për zgjedhjet e vjedhura presidenciale në vitin 2020.

Republikanët kryesorë flasin gjithashtu për një "kthim në normalitet" në zgjedhjet e Kongresit. Por Trump ka qenë prej kohësh pjesë e normalitetit republikan. Vetë Trumpi e ndihmoi të bëhej rivalin e tij ndoshta më të madh për kandidaturën republikane, guvernatorin e sapozgjedhur të Floridas, Ron DeSantis.

"Një Trump me tru", quhet tani ai. Por asgjë nuk urren Trump më shumë sesa kur dikush guxon të dalë nga hiya e tij. I indinjuar, ai e përshkruan DeSantis si "hipokrit" pasi pozon si një rival i mundshëm.

Mike Pence, ish-zëvendëspresidenti i Trump, gjithashtu po bën nxehjen për të garuar vetë për Zyrën Ovale. "Ndaj më ndihmo Zot" quhet libri i tij, i cili po promovohet tani me intervista, në të cilat ai "zbulon" kërcënimin e bërë nga Trump më 6 janar 2021, ditën kur u sulmua Kapitol.

Një fushë e tërë rivalësh në partinë e tij, rezultate të këqija për kandidatët e tij në zgjedhjet afatmesme dhe më pas hetimet e shumta që po zhvillohen kundër tij - ndër të tjera, për shkak të tentativës për manipulim zgjedhjesh në Georgia dhe për

përvetësimin e supozuar të sekretit të lartë. dokumente, të gjetura në resortin e tij të golfit Mar-a-Lago: Sipas ligjeve të politikës, shenjat tani duket se janë kundër Trumpit.

Trump, përçarës

Por ishin pikërisht këto ligje që ai vetë i rishkruan vazhdimisht. Arma e tij politike është përçarja. Dhe për të vlen: sa më shumë padi kundër tij, aq më shumë municion ka ai. Për të ato janë provë e "persekutimit" të tij.

Rreth një e treta e votuesve republikanë - mendohet - se besojnë tek ai: Pavarësisht gjithë zhgënjimeve me Trumpin, edhe në radhët e republikanëve, ata mbeten të bashkuar pas tij. Nëse një grup republikanësh ndihen të detyruar të shpëtojnë partinë nga Trumpi në

vitin 2024, kjo mund të dështojë. Sepse një e treta mund të mjaftojë lehtësisht për një fitore të Trumpit në zgjedhjet paraprake për kandidaturën e republikanëve.

Dhe edhe nëse nuk mjafton, ai përsëri fiton, sepse një gjë është e qartë: Donald Trump e ka deformuar Partinë Republikane sipas imazhit të tij. Ajo nuk e njeh më veten. Trumpizmi është bërë pjesë e politikës amerikane. Dhe është pavarësuar nga domeni politik. Ai ushqehet me përçarjen e shoqërisë amerikane. Kjo përçarje duhet të zbutet, sepse prej saj do të varet në fund të fundit edhe stabiliteti i Perëndimit dhe i demokracisë në botë. Kështu që përbindëshi politik Trump mund të mposhtet vetëm nga shumica e heshtur. Zgjedhjet afatmesme sapo kanë treguar se kjo shumicë ekziston ende në të gjitha kampet./DW

Rusia hyn në recesion!

Rusia ka hyrë në një recesion, nëntë muaj pas nisjes së pushtimit në Ukrainë, ndërsa sanksionet perëndimore rëndojnë mbi ekonominë. Produkti i brendshëm bruto u tkurr me katër për qind në tremujorin e tretë, sipas një vlerësimi paraprak nga agjencia kombëtare ruse e statistikave Rosstat. Duke qenë se kjo pason një të

njëjtën rënie në tremujorin e dytë, Rusia tani përmbush përkufizimin teknik të një recesionit me dy tremujorë radhazi të rënies së PBB-së. Ekonomia e Rusisë ka qenë duke luftuar nën një mori problemesh. Sanksionet perëndimore kanë kufizuar eksportet dhe importet, duke përfshirë komponentët kryesorë të prodhimit dhe pjesët

rezervë.

Kompanitë gjithashtu kanë vuajtur nga mungesa e personelit pasi mobilizimi i pjesshëm i Vladimir Putin ka nxjerrë mijëra njerëz nga fuqia punëtore.

Megjithatë, rënia prej katër për qind e prodhimit ekonomik midis korrikut dhe shtatorit ishte më pak se tkurrja prej 4.5 për qind që shumë analistë prisnin.





QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Licencohen Federata e Xhudos dhe e Hendbollit

Prishtinë, 17 nëntor - Dy federatat sportive të Kosovës, Federata e Xhudos dhe Federata e Hendbollit, janë licencuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ministri Hajrullah Çeku ka nënshkruar licencat për këto federata sportive. "Ministri i Sportit, Hajrullah Çeku, ka

nënshkruar licencat e radhës për federatat sportive, sipas udhëzimit të ri administrativ për licencimin e federatave. Pas rekomandimit pozitiv të Komisionit për Licencim, në kuadër të Ministrisë së Sportit, ministri Çeku i ka dorëzuar zyrtarisht licencën për

ushtrimin e veprimtarisë kryetarit të Federatës së Xhudos, Agron Kuka dhe kryetarit të Federatës së Hendbollit, Eugen Saraçini. Përgëzime për të dy Federatat dhe suksese në veprimtarinë e tyre!", thuhet në njoftimin e MKRS-së.



Flamurtari dhe Prizreni shkaktojnë befasi në Kupë, eliminojnë Drenicën dhe Istogun



PRISHTINË, 17 NËNTOR - Janë zhvilluar trembëdhjetë ndeshje në kuadër të 1/16 së finales së Kupës së Kosovës në futboll. Për befasi në këtë rreth janë përkujdesur Flamurtari dhe Prizreni, që eliminuan Istogun dhe

Drenicën. Prizreni pas vazhdimeve ka arritur ta mposhtë skuadrën e Ligës së Parë, Istogun, me rezultat 2-0, kurse kuqezinjtë e kryeqytetit e mposhtën skuadrën kuqezi nga Skenderaj, Drenicën, pas

penalltive, me shifrat 8:7. Koha e rregullt dhe vazhdimet përfunduan me rezultat të barabartë (0-0). Në ndeshjet e tjera kryesisht kanë fituar skuadrat që janë vlerësuar favorite. Skuadra

Kupa e Kosovës - 1/16 e finales

Llapi - Vllaznia Pozheran	6-2
Dukagjini - Rilindja 1974	2-0
Prizreni - Istogu	0-0 (2-0 pas vazhdimeve)
Feronikeli '74 - 2 Korriku	4-1
Vushtrria - Drenasi	1-0
Vjosa - Ulpiana	1-0
Drenica - Flamurtari	2-2 (2-2 në vazhdim, 7-8 në penallti)
Behari - Ferizaj	2-3
A&N - Rahoveci	2-1
Fushë Kosova - Arbëria	4-1
Ramiz Sadiku - Malisheva	0-4
Trepça '89 - Kika	3-0
Trepça - Gjilani	0-5
Vëllaznimi - Prishtina (Vëllaznimi hoqi dorë nga garat)	

Më 23 nëntor takohen:
Drita - Liria

Më 24 nëntor takohen:
Phoenix - Ballkani

fituese e trofeut të kësaj gare në edicionin e kaluar, Llapi, ka fituar pa vështirësi ndaj Vllaznisë së Pozheranit me rezultat 6-2. Fitore bindëse ka shënuar Gjilani me rezultat 5-0 ndaj skuadrës së

Trepçës. Prishtina është kualifikuar pa zhvilluar ndeshje fare për faktin se Vëllaznimi nga Gjakova është tërhequr nga garat. Dy ndeshjet e fundit të kësaj faze zhvillohen më 23 dhe 24 nëntor.

Sonte derbi në mes të Penzës dhe Bashkimit



Pejë, 17 nëntor - Xhiroja e pestë në Superligën e femrave do ta sjellë përballjen mes rivalëve të vjetër të basketbollit të femrave, Penzës dhe Bashkimit. Skuadra pejana ka tri fitore e dy humbje, kurse ajo prizrenase ka pesë fitore në po aq ndeshje, duke qenë skuadra e vetme pa humbje në elitën e femrave. Këto dy skuadra ishin ndeshur edhe në finalen e Superkupës së Kosovës, ku fitoi skuadra prizrenase, që e fitoi edhe përballjen e parë të këtij edicioni, 71:67. Takim interesant shihet në mes të United Basketballit

dhe Trepçës, ku skuadra gjilanase ka dy fitore e tri humbje, ndërsa ajo mitrovicase një fitore e katër humbje. Vëllaznimi, që ka pesë humbje në pesë ndeshje, do të ndeshet me Prishtinën, që numëron katër fitore e një humbje, duke qenë favorite e kësaj sfide.

Superliga e Femrave - Java 6

Të premtën takohen:
19:00 Penza - Bashkimi

Të dielën takohen:
13:00 United Basketball - Trepça
16:30 Vëllaznimi - Prishtina

Daku tregon pse u largua nga grumbullimi i Kosovës

Prishtinë, 17 nëntor - Sulmuesi Mirilind Daku ishte i ftuar nga trajneri i Përfaqësueses së Kosovës, Alain Giresse, për miqësoren kundër Armenisë, por ai mungoi në këtë ndeshje.

Daku nëpërmjet një postimi në "Facebook" ka bërë me dije se lëndimi ka qenë arsye se ai ka munguar në këtë ndeshje. "Pas një sëmundjeje që pata u detyrova të largohem nga

grumbullimi me Kosovën. Më vjen shumë keq që nuk munda të jem në fushë për t'i ndihmuar shokët e skuadrës. Faleminderit të gjithëve për mesazhet dhe kujdesin! Tani jam duke marrë

terapinë dhe po bëj më mirë", ka thënë Daku. Ndeshja miqësore në mes të Kosovës dhe Armenisë, e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri", përfundoi me rezultat 2-2.



Reja: Meritonim më shumë ndaj Italisë

TIRANË, 17 NËNTOR - Kombëtarja e Shqipërisë pësoi humbje në miqësoren ndaj kampiones në fuqi të Evropës, Italisë. Ndashja e zhvilluar në "Air Albania Stadium" përfundoi me rezultatin 1-3. Edoardo Reja pas ndeshjes ka thënë se i

pëlqeu paraqitja e futbollistëve kuqezi pavarësisht prej rezultatit. "Kemi bërë mirë në fillim, por pas golit kemi pasur dy rivënie anësore, ku u kemi dhuruar topin. Unë doja që të bënim, por nuk bëmë mirë. Në pjesën e dytë bëmë më mirë, u

ngritëm më lart dhe krijuam 4 apo 5 raste. Kemi bërë një ndeshje shumë të mirë, me disa raste dhe dy traversa, ndaj më pëlqeu paraqitja e skuadrës. Meritonim diçka më shumë sa i përket rezultatit", ka thënë Reja. Trajneri italian tha se do të

ketë disa ndryshime për ndeshjen e radhës miqësore kundër Armenisë. "Do të ketë disa ndryshime, pasi duhet t'i bëjmë vlerësimet tona. Broja është dëmtuar, por Skuka erdhi nga stoli dhe bëri shumë mirë. E komplimentoj", ka shtuar Reja.



Ronaldo: Isha shumë afër Cityt, por vendosi e kaluara ime

MANCHESTER, 17 NËNTOR - Cristiano Ronaldo vijon të zbulojë detaje të tjera të rëndësishme nga karriera e tij. Ai vendosi të rikthehet te Manchester Unitedi në ditët e fundit të gushtit të vitit 2021, edhe pse, në fakt, ishte shumë pranë një kalimi te Manchester City. "E them sinqerisht, unë isha shumë afër kalimit te Manchester City, bisedova shumë me të, e tha edhe Guardiola dy javë më parë. Ata u përpoqën shumë të firmosnin me mua. U habita disi, por zemra ime foli me zë të lartë në atë moment. Historia që kisha në Manchester United dhe Sir Alex Ferguson bënë ndryshimin. Unë nuk e mohoja, e mora me vetëdije dhe zemër vendimin për t'u rikthyer. Fola me Ferguson dhe ai më tha: 'Është e pamundur që ti të shkosh në Manchester City'. Unë iu përgjigja: 'Mirë, shef'. Nuk mund t'i ktheja shpinën të kaluarës sime. Nuk pendohej që u riktheva tek Unitedi. Biseda me Fergusonin ishte vendimtare. Aty kuptova se nuk mund të bëhesha pjesë e



Manchester Cityt", ka thënë Ronaldo. "Rangnick? E thërrisja shef si gjithë trajnerët e tjerë në karrierë, por thellë brenda vetes nuk e pashë kurrë si një trajner. Solskjaer? E adhuroj, mendoj se ai është një person i mrekullueshëm, por nuk e kishte të lehtë të bënte gjëra të bukura pas largimit të Fergusonit. Gjithsesi, unë mendoj se Ole ka zhvilluar një punë të mirë si trajner i Unitedit, por ai kishte nevojë për më shumë kohë", ka shtuar portugezi.

Cristiano Ronaldo ka thënë se trajnerët në United mendojnë se janë Coca Cola e fundit që ka mbetur në shkretëtirë. "Pse flas? Sepse kështu e ndiej, më pëlqen të flas. Nuk arrij të kuptoj një gjë, tek Unitedi vijnë trajnerë që mendojnë se janë Coca Cola e fundit që ka mbetur në shkretëtirë... Unë i respektoj të gjithë, çdo qasje dhe mentalitet të ndryshëm, por me disa pika nuk mund të pajtohem vërtet", ka deklaruar Ronaldo.

Bostoni dhe Milwaukee komandojnë në Lindje

MILWAUKEE, 17 NËNTOR - Skuadra e Boston Celticsit vijon ta udhëheqë kreun e renditjes në Konferencën e Lindjes, duke fituar me rezultat 126-101 ndaj Atlantias jashtë fushës. Shtatë lojtarë të Bostonit realizuan mbi 10 pikë, duke e bërë kolektivitetin si armën më të fortë. Fiton edhe Milwaukee, që mundi me rezultat 113-98 Clevelandin, ndeshje ku u dallua Lopez me 29



pikë. Skuadra e Torontos, falë 32 pikëve e 10 reboundeve të Anunoby, mposhti Miamin (112-104), ndërsa Denveri u mund me shifrat 106-103 në fushën e tij nga New Yorku. Sidë e dobët nga skuadra vendase (u ndje mungesa e Donçiqit), ndërkohë që për një-jorkezët u dallua Randle me 34 pikë

e 11 rebounde. Në Perëndim, skuadra e Phoenixit mposhti me rezultat 130-119 rivalët e Golden States, në një ndeshje me emocione. Curry realizoi 50 pikë për kampionët, por që s'mjaftuan për të fituar. Të gjithë titullarët e Phoenixit realizuan mbi 14 pikë (Payne me 29 pikë më i miri në parket për Suns).

REZULTATET

Charlotte - Indiana	113-125
Orlando - Minnesota	108-126
Washington - Oklahoma	120-121
Atlanta - Boston	101-126
Toronto - Miami	112-104
Milwaukee - Cleveland	113-98
New Orleans - Chicago	124-110
Dallas - Houston	92-101
Denver - New York	103-106
Phoenix - Golden State	130-119

Mick Schumacher: Prisja rinovimin, do të rikthehem në Formula 1

Piloti gjerman Mick Schumacher ka mbetur i zhgënjyer nga vendimi i marrë prej makinës amerikane Haas, që nuk ia rinovoi kontratën. Vendin e tij do ta zërë Nico Hulkenberg. Gjithsesi, djali i shtatë herë kampionit të botës

nuk heq dorë nga Formula 1 dhe shprehet se do ta rishohim shpejt në pistë. Mick rrëfen gjithçka përmes një komunikate për shtyp, në prag të garës së fundit në Abu Dhabi. "Kjo do të jetë gara ime e fundit me Haas. Nuk dua ta fsheh faktin se kam

mbetur i zhgënjyer nga vendimi për të mos rinovuar kontratën mes nesh. Gjithsesi, dua të falënderoj Haas, F1 dhe Ferrari për mundësinë që më dhanë!", ka thënë fillimisht Mick Schumacher. "Këto vite që kaluam së

bashku më kanë ndihmuar të rritem si nga ana teknike ashtu edhe nga ajo personale. Sidomos në momentet e vështira kam kuptuar se sa shumë e dua këtë sport. Disa herë ka qenë e vështirë, por jam përmirësuar në mënyrë

konstante, kam mësuar shumë dhe e di se meritoj një vend në Formula 1. Momentet e vështira të bëjnë më të fortë. Brenda meje digjet zjarri për Formula 1 dhe do të punoj fort për t'u rikthyer", ka shtuar Mick Schumacher.

SHKURT

Hyseni rikthehet në stërvitje

FC Prishtina mori një lajm të mirë pasi që mesfushori-sulmues Hasan Hyseni është rikthyer në stërvitje të plota me skuadrën. Hyseni në ndeshjen me Malishevën, e zhvilluar më 14 shtator, e ka këputur ligamentin e jashtëm lateral, ndërkohë që shërimi i tij ka shkuar shumë mirë nën kujdesin e mjekut Qërim Kida. Ndryshe nga Hyseni, Mërgim Pefqeli vazhdon të jetë i lënduar. Ai i ka dëmtuar tri ligamente të njëjës së këmbës dhe pas kontroleve të kryera rezultojnë se do të mungojë tri deri në pesë javë.

Mançini: Shqipëria bëri një ndeshje të mirë

Pas miqësorës Shqipëri - Itali të përfunduar me rezultatin 1-3, trajneri Roberto Mançini e komplimentoi skuadrën kuqezi teksa, ndër të tjera, u shpreh lidhur edhe me të ardhmen e mbrojtësit Leonardo Bonucci. "Është një skuadër e mirë, e dinim këtë. Shqipëria bëri një ndeshje të mirë. Ka lojtarë të mirë, luajnë në Serinë A, kanë kualitet, u bëj komplimente. I falënderojmë që na ftuan për këtë miqësore", ka thënë Mançini. I pyetur se kush e zëvendëson Bonuccin, Mançini është përgjigjur: "Kemi mbrojtës të mirë, kemi lojtarë të ndryshëm. Bonucci është ende me ne dhe ka përvojën që na nevojitet".


FIFA: Maluma dhe Myriam Fares performojnë në hapjen e Kampionatit Botëror

Tash e sa kohë flirtet për hapjen e madhe të Kampionatit Botëror 2022, i cili nis këtë të diel më 20 nëntor. Mes shumë emrave të përfolur për të kënduar në ceremoninë e madhe hapëse, shumë prej tyre i refuzuan ftesat. Këngëtarja Shakira thuhet se ka hedhur poshtë ftesën për të performuar në hapje, ndërsa e shumëpërfolura Dua Lipa ka thënë se as nuk ka qenë e negociuar që të performojë. Artistja shqiptare madje shkoi aq larg sa tha që nuk do të shkojë në Katar pas kritikave që ky shtet nikoqir i kampionatit ka marrë për mosrespektim të të drejtave të njeriut. Faqja zyrtare e FIFA-s në "Facebook" njoftoi artistët që tashmë janë konfirmuar që do të interpretojnë në ceremoninë hapëse. Ata do të jenë këngëtarë kolumbian me famë botërore Maluma dhe këngëtarja e famshme libaneze Myriam Fares. "Le të fillojë festa! Fifa Fan Festival hapet më 19 nëntor në një hapje madhështore, Maluma dhe Myriam Fares po e nisin atë me stil në Al Bidda Park", thuhet në njoftimin e FIFA-s.

Interi dhe Juventusit e duan Kanten

Mesfushori i Chelseat, Ngolo Kante, ka përfunduar në "radarin" e dy klubeve italiane, Inter dhe Juventus. Lajmi është bërë me dije nga "Repubblica". Mesfushorit francez në qershor i përfundon kontrata me Chelsean dhe mund të largohet si lojtar i lirë. Nëse këto skuadra e duan Kanten në janar, atëherë klubi anglez i dëshiron 20 milionë euro.

KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE
"Ambienti" SH.A. PEJË
Nr. 1735
Data: 17.11.22



**NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "AMBIENTI" SH.A
LOCAL PUBLIC ENTERPRISE "AMBIENTI" J.S.C
LOKALNO JAVNO PREDUZEÇE „AMBIENTI“ A.D**

Adresa: Zyrat qendrore Rr. Xhem Sadrija p.n, 30000 PEJË
Email: krm.ambienti@yahoo.com

Në bazë të nenit 21 të Ligjit numër 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 15.06.2008), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 04/L-111 (i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 30.05.2012), nenit 15 paragrafi 2.2 pika (Dh) të Statutit të NPL "Ambienti" Sh.A., Bordi i Drejtorëve shpall ketë:

KONKURS

Pozita: Zyrtar/re Kryesor Financiar dhe i Thesarit

Kohëzgjatja e mandatit: 3 (tre) vite – me mundësi vazhdimi
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv
Orari i punës: I plote
Vendi: Pejë

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:
Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l), nenit 17.3 pika (a), dhe (b), detyrimit të dhënies së deklaratës nën betim sipas nenit 17.5 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe se kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Kandidati/ja duhet të ketë diplomë universitare me të paktën 240 kredi/ECTS ose master, në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante. Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Të ketë së paku 3 vite përvojë në nivel të lartë të menaxhimit në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim i thesarit, banka, konsulencë në biznes, industri ose nga një fushë tjetër e shkencës e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së për së paku 3 vite, të ketë qenë kontabilist publik, ose anëtarë i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlikohet ngushte me veprimtarinë afariste të NP;
- Të ketë njohuri në interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) në bazë të cilave raporton Ndërmarrja.
- Ekspert i certifikuar në kontabilitet apo ndonjë fushë tjetër në kuadër të financave;
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Në mos jetë i dënuar ose nën hetime;
- Një program zhvillimor për kompaninë.

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Është përgjegjës për zbatimin e të gjitha dispozitave financiare dhe standardeve të kontabilitetit, ligjet e aplikueshme në Kosovë të cilat rregullojnë çështjet financiare dhe aktet normative të ndërmarrjes;
- Organizon udhëheq dhe kontrollon punën e departamentit financiar;
- Mban përgjegjësi për pagesën e obligimeve financiare në pajtim me rregulloret financiare;
- Mban evidencë dhe dokumentacion të saktë për investimet dhe pagesat e ndërmarrjes;
- Përcjell dispozitat financiare në fuqi dhe literaturën profesionale dhe mban përgjegjësi nëse nuk aplikohen ligjet në fuqi;
- Kujdeset për pasurinë e ndërmarrjes, monitoron punën e komisioneve, kontrollon hyrje -daljet financiare në përgjithësi;
- Përcjell gjendjen financiare në banka dhe bashkëpunon me institucionet bankare dhe organet tjera në interes të ndërmarrjes;
- Përgatit llogaritë periodike dhe përfundimtare;
- Është përgjegjës për përgatitjen e transfereve bankare përkatësisht pagesave me dokumentacion mbështetës dhe siguron KE-në se pagesa është në rregull;
- Harton, zbaton dhe kontrollon zbatimin e procedurave financiare nga vartësit;
- Është përgjegjës të kontrollojë mbajtjen në rregull të arkivit të dokumentacionit të kontabilitetit dhe atij financiar;
- Zhvillon dhe zbaton rregullat e brendshme të kontrollit si dhe udhëzimet dhe procedurat për aktivitetet si administrimi i buxhetit, menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve dhe mbajtja e llogarive;
- Është përgjegjës për rregullsinë e proceseve në funksionin e kontabilitetit në kompani, përgatit dhe zbaton procedurat e kontabilitetit sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Të përgatis të dhënat e ndërmarrjes për auditim;
- Mbanë përgjegjësi për kryerjen e regjistrimeve dhe barazimeve të pasurisë së Ndërmarrjes;
- Përgatit raportet periodike dhe vjetore të Ndërmarrjes për KE dhe Bordin e Drejtorëve.
- Ushtron kujdes për ecurinë e shpenzimeve të Ndërmarrjes, pagesën e obligimeve Ligjore dhe afarizmin e Ndërmarrjes;
- ZKF i përgjigjet: Bordit të Drejtorëve, kryen edhe punë të tjera, për të cilat autorizohet nga KE

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Procedura e aplikimit:
Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:


- CV-ja (Biografia)
- Letër motivuese
- Dëshmitë mbi kualifikimin profesional (diplomën) – kopje
- Dëshmitë për përvojën e punës
- Programi zhvillimor për kompaninë në aspektin e menaxhimit të financave.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 1 muaj – origjinale;
- Deklarata nën betim; (**merret brenda ndërmarrjes në kopje fizike para se të dorëzohet aplikacioni**)
- Letërnjoftimi - kopje;

Afati për aplikim është 30 ditë duke filluar nga data e shpalljes së konkursit me dt. 17.11.2022 deri më 17.12.2022 ora 16:00.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur që i plotësojnë kushtet do të ftohen në intervistë.

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Sekretaria e Kompanisë në zarf të mbyllur me shënim: "Për pozitën: Zyrtar kryesor Financiar dhe i Thesarit i NPL "Ambienti" Sh.a. Kërkesat e dorëzuara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim.

KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE
"Ambienti" SH.A. PEJË
Nr. 1736
Data: 17.11.22



**NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "AMBIENTI" SH.A
LOCAL PUBLIC ENTERPRISE "AMBIENTI" J.S.C
LOKALNO JAVNO PREDUZEÇE „AMBIENTI“ A.D**

Adresa: Zyrat qendrore Rr. Xhem Sadrija p.n, 30000 PEJË
Email: krm.ambienti@yahoo.com

Në bazë të nenit 21 të Ligjit numër 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 15.06.2008), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 04/L-111 (i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 30.05.2012), nenit 15 paragrafi 2.2 pika (Dh) të Statutit të N.P.L "Ambienti" Sh.A, Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 14.11.2022, vendosi të Ri-shpall ketë:

KONKURS

Pozita: Kryeshef Ekzekutiv

Kohëzgjatja e mandatit: 3 (tre) vite – me mundësi vazhdimi
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve
Orari i punës: I plote
Vendi: Pejë

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:
Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l), nenit 17.3 pika (a), dhe (b), detyrimit të dhënies së deklaratës nën betim sipas nenit 17.5 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe se kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Kandidati/ja duhet të ketë diplomë universitare me të paktën 240 kredi/ECTS ose master, në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante. Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë në nivel të lartë të menaxhimit në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim i thesarit, banka, konsulencë në biznes, industri ose nga një fushë tjetër e shkencës e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së për së paku 5 vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtarë i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlikohet ngushte me veprimtarinë afariste të NP-së;
- Njohuri të avancuara në fushëveprimin e ndërmarrjeve publike.
- Njohuri mbi funksionimin dhe legjislacionin në fushën e trajtimit të mbeturinave.
- Të ketë integritet të lartë moral e profesional.
- Aftësi për udhëheqje dhe arritjen e objektivave të ndërmarrjes.
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi.
- Preferohet njohuri të avancuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe pakove standarde softuerike.
- Aftësi të shkëlqyeshme organizative dhe planifikuese.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimit në të shkruar dhe të folur.
- Të mos jetë i dënuar ose nën hetime.

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore të Kryeshefit Ekzekutiv:

- Ne pajtim me Ligjin, Kodin e Etikes, Qeverisjen Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe Statutin, duke iu nënshtruar vetëm përkufizimeve të BD ka autoritetin të lidhë kontrata për Kompaninë;
- Së bashku me ekipin e menaxhimit ekzekutiv të përpilohet dhe implementoj planin vjetor afarist dhe planet strategjike tek Bordi që do të sigurojnë rritjen fitimprurëse të Ndërmarrjes dhe arritjen e objektivave të saj;
- Të shqyrtoj dhe raportoj tek Bordi progresin e përgjithshëm në sfond të objektivave operative dhe financiare dhe të inicijoj masa të veprimit për zbatim;
- Të sigurohet që janë të vendosura proceset dhe sistemet që i mundësojnë atij ta mbajë Bordin të informuar për të gjitha aktivitetet e Ndërmarrjes dhe faktorët e jashtëm që burojnë nga veprimtaria, tregu dhe rregullatorë;
- I ofron Bordit të Drejtorëve kurdo që është e nevojshme dhe së paku një herë në tre muaj raporte për transaksionet kryesore të ndërmarrja nga kompania dhe për vendimet kryesore të ndërmarrja nga menaxhmenti në lidhje me udhëheqjen e biznesit dhe të punëve të kompanisë;
- Ofron Bordit të Drejtorëve rregullisht së paku çdo tre muaj raportet e matjes së performancës së kompanisë;
- Themelon dhe rishikon strukturën organizative të kompanisë, si dhe të fuqisë së ndërlidhjes në mes të udhëheqësve dhe të punësuarve në kompani;
- Është kompetent dhe përgjegjës për të gjitha punët dhe veprimtaritë e Ndërmarrjes konform Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike, Statutit, Rregulloreve të Ndërmarrjes;
- Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e përgjithshme.

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Procedura e Aplikimit:
Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia)
- Letër motivuese
- Dëshmitë mbi kualifikimin profesional (diplomën) – kopje
- Dëshmitë për përvojën e punës
- Programi zhvillimor për kompaninë.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 1 muaj – origjinale;
- Deklarata nën betim; (**merret brenda ndërmarrjes në kopje fizike para se të dorëzohet aplikacioni**)
- Letërnjoftimi - kopje;

Afati për aplikim është 14 ditë duke filluar nga data e shpalljes së konkursit me dt. 17.11.2022 deri më 01.12.2022 ora 16:00.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur që i plotësojnë kushtet do të ftohen në intervistë.

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Sekretaria e Kompanisë në zarf të mbyllur me shënim: "Për pozitën: Kryeshef Ekzekutiv i NPL "Ambienti" Sh.A. Kërkesat e dorëzuara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1664/1
Dt: 17.11.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

Ri-SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendit të lirë në Qendren e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
QeK	Qendra e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtinë	Një mësimdhënës/e për lëndën Gjuhë dhe Letërsi Angleze me 16 orë mësimore	Vendi i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të silltet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 7 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi" në Prishtinë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1664/1
Dt: 17.11.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendit të lirë në Qendra e Kompetencës në Skenderaj për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Një (1) instruktor për Instalues të ngrohjes dhe ventilimit të ajrit 20 orë mësimore	Vendi lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor:

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 6 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës së punës;
- Për vendin e shpallur të punës në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica
NPL - "Qendra Multifunkionale" SH.A.



Në bazë të dispozitave të nenit 21, nenit 25 paragrafi 25.2 pika h të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndermarrjet Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr 31/15 Qershor 2008), respektivisht neni 13 të Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit bazik për Ndermarrjet Publike nr. 03/L-087, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 13/30 Maj 2012), dhe Ligjin nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, si Udhëzimin Administrativ nr. 07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komisioni i Auditimit në NPL "Qendra Multifunkionale" SHA, Mitrovicën në mbledhjen e mbajtur me datë 17.11.2022 mori vendim që me datë 18.11.2022 të shpall.

KONKURS

Tutulli i vendi të punës – Auditor/e i/e Brendshëm/c
I përgjigjet: Komisionit të Auditimit.
Vendi: Mitrovicë.
Numri i pozitave 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: Në kohë të caktuar puna provuese gjashtë (6) muaj, me mundësi vazhdimi në pajtim me Ligjin e Punës dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësit e punës:

- Përpilimi i procedurave të auditimit, gjegjësisht planit të auditimit të brendshëm për të gjitha transaksionet e NP, konform objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të NP-së, të bazuara në Ligjin e aplikueshëm.
- Udhëheqjen, menagjimin dhe organizimin e brendshëm të Zyrës së Auditimit.
- Auditimi i planeve investive dhe financiare të NP-së, planit vjetor të biznesit dhe buxhetit vjetor.
- Auditimi i pasqyrës vjetore të bilancit dhe deklaratat e fitimeve dhe humbjeve si dhe deklaratat financiare që kërkohen me Ligj.
- Vlerësimi objektiv dhe shfrytëzimi efektiv i burimeve të NP-së si dhe dhënjia e rekomandimeve adekuat për Komisionin e Auditimit.
- Verifikimi i përshtatshmërisë dhe funksionimi i rregullt i sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojn zbatimin nga NP-ja, të gjitha Ligjet e aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe ti siguroj Komisionit të Auditimit çfado vërejtje apo sugjerimet e cilat konsiderohen të nevojshme.
- Verifikimi i rregullt i përshtatshmërisë dhe funksionimi i rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i NP-së, duke përfshir dokumentacionin financiar mbahet në përputhje me standartet e Kontabilitetit dhe Ligjin, dhe që prejekt deklaratat vjetore financiare të përgaditët në mënyrë të rregullt.
- Analisa e sistemeve dhe procedurave të biznesit dhe kontrolleve të ndërlydhura me to.
- Raportim i rregullt para Komisionit të Auditimit dhe përbushja e çfardo detyre tjetër të përcaktuara nga Komisioni i Auditimit.

Paga: Në pajtim me politikën e kompenzimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Komisioni i Auditimit dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nent 17.1 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndermarrjet Publike të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndermarrjet Publike, dhe poashtu secili kandidat duhet të përmbushë të gjitha kushtet e pavarësisht ashtu sikurse parashihet në nenin 17.2 (d), (f), (k), (l) të Ligjit nr.03/L-087 për Ndermarrjet Publike të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndermarrjet Publike.

Kushtet e përgjithshme:

- Të ketë Diplomë Fakulteti Ekonomik, 4 vjeçare ose me sistem të Bolonjës 3+2.
- Të ketë së paku (3) vite përvoj pune në fushën e kontabilitetit, financa si dhe përparësi ka përvoja në fushën e Auditimit.
- Të jetë kontabilist i/e çertifikuar, i/e çertifikuar për Auditim të Brendshëm ose Auditor në njëren prej institucioneve të Licensuara nga Ministria e Financave të Kosovës.

Kushtet e veçanta:

- Të ketë inegritet të lartë moral dhe profesional (njohuri të qasjeve moderne në planifikimi dhe kontroll, njohuri të Ligjeve, Rregulloreve dhe Udhëzimeve Administrative të aplikueshme, shkathhtësi hulumtuuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale).
- Të ketë aftësi organizative.
- Të ketë njohuri të punës me kompjuter, Word, Excel, Power Point.
- Të mos jetë i/e dënuar ose nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj)
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Procedurat e aplikimit

- Aplikacionin.
- CV-në.
- Dëshminë e shkollimit.
- Çertifikatën për Auditor të Brendshëm.
- Referenca si dhe çertifikatat tjera profesionale.
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 6 muaj).
- Kopja e dokumentit të identifikimit.

Dokumentacioni i aplikatëve mund të dorëzohet në zyrat e NPL "Qendra Multifunkionale SH.A. Mitrovicë çdo ditë pune nga ora 08:00 - 16:00 deri me datë 02.12.2022
Të gjitha dokumentet të paraqiten në kopje dhe dorëzohet në zarf të mbyllur me shënim për Auditor të Brendshëm.

Komisioni i Auditimit

Leunora Arapij - Kryesues



Qendra Multifunkionale SHA. Mitrovicë

dt. 18.11.2022

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Easy Callers" SH.P.K. me pronar Bledar Smajl dhe Arsim Smajli, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810091140 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Easy Callers" D.O.O. Bledar Smajl dhe Arsim Smajli, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810091140 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Easy Callers" L.L.C. Bledar Smajl dhe Arsim Smajli, has come to the decision to quit its business: 810091140 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Blerta Sinani shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Oda e Infermierëve të Kosovës KO-3334/A-06/20.

- Ingrid Kuqi shpall të pavlefshme Certifikatën e lëshuar nga Qendra për Aftësim Profesional në Mitrovicë datë: 13.11.2017 me nr. të certifikatës 570/2017.

- Bylbyl Gegollaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Pjetër Budi " Lubizhd Has.

- Vullnet Kastrati shpall të pavlefshme 3 dëftesat , diplomën , certifikatën shmt "11 Marsi " Prizren.

- Mirsen Sadiku shpall të pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Jeton Makolli shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e Gjimnazit "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Besart Halimi B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb. 810949761.

- Skender Idrizi B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e TVSH-se.

- Edon Shala shpalle te pavlefshme dëftesën e klasës se 9-te te shkollës fillore " Bedri Gjinaj".

- Hakif Preteni shpalle te pavlefshme dëftesën e klasës se 8-te te shkollës fillore " Trepca".

- Xheneta Osmani shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLM " Dr Xheladin Deda".

- B-TEX B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nr 601134761.

- Naim Sadrijaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U "Haxhi Hoti" Rogov KK Gjakovë nga kl. I-VIII.

- Rexhep Sadrijaj nga Ujzë KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U "Haxhi Hoti" Rogovë KK Gjakovë nga kl. I-VIII.

- Durim Sadrijaj nga Ujzë KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U "Pjetër Bogdani" Pnsh KK Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

